



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme nr.06/L-005, nenet 14 dhe 15 dhe të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 27 shtator 2021, miratoi këtë,

### VENDIM PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2022

#### Neni 1

##### Normat Tatimore

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2022 për të gjitha kategoritë e pronave në territorin e Komunës së Podujevës, me përjashtim të kategorisë-pronë publike, si vijon:

1.1. Për njësiti bujqësore të parcelave.....	0.15 %
1.2. Për njësiti bujqësore të objekteve.....	0.15 %
1.3. Për njësiti pyjore të parcelave.....	0.15 %
1.4. Për njësiti rezidenciale të parcelave.....	0.15 %
1.5. Për njësiti rezidenciale të objekteve.....	0.15 %
1.6. Për njësiti komerciale të parcelave.....	0.15 %
1.7. Për njësiti komerciale të objekteve.....	0.20 %
1.8. Për njësiti industriale të parcelave.....	0.15 %
1.9. Për njësiti industriale të objekteve.....	0.20 %

2. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, (neni 9 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9).

#### Neni 2

##### Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

#### Neni 3

##### Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, dhe i njëjti zbatohet nga data 01 janar 2022.

Nr.prot. 01-430/02-0085308/21  
Podujevë,  
27 shtator 2021



Kryesuesi i Kuvendit  
Fatmir Gashi